



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 01.10.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BASHKIMI EUROPIAN- SHQIPËRI, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME CILËSINË E VËZHGUESES, NË PUNËN E AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE DHE MËNYRËN E KËSAJ PJESËMARRJEJE NË KUADRIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT (KE) NR.168/2007”

- **Hyrje**

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **01.10.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin *“Për Ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Europian- Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr.168/2007”*.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Drejtësisë e përfaqësuar nga Znj. Fioralba Cakaj, Zevendesministre.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Drejtësisë, në mbështetje të neneve 78 , 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës,

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit**

Projektligji i propozuar ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian- Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr.168/2007.

Agjencia e Bashkimit European për të Drejtat Themelore (“Agjencia”) është krijuar me Rregulloren e Këshillit (KE) nr.168/2007, datë 15 Shkurt 2007. Objektivi i Agjencisë është t’u ofrojë institucioneve të BE-së dhe Shteteve të tij Anëtare asistencë dhe ekspertizë lidhur me të drejtat e njeriut kur zbatojnë të drejtën e BE-së (Neni 2 i Rregullores (KE) nr.168/2007).

Sipas pikës 1 të nenit 28 të Rregullores së Këshillit (KE) nr.168/2007, **Agjencia është e hapur për pjesëmarrjen e vendeve candidate si vëzhguese.** Pjesëmarrja dhe modalitetet e pjesëmarrjes së Shtetit kandidat përcaktohen me vendim të Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE - Shteti Kandidat përkatës.

Pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë me cilësinë e vëzhgueses në Agjencinë e Bashkimit European për të Drejtat Themelore u miratua nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri në datën 9 Shkurt 2018. Gjithashtu ky vendim përcakton edhe modalitetet e pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë me cilësinë e vëzhgueses në Agjencinë e Bashkimit European për të Drejtat Themelore.

Vendimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri përcakton se Agjencia mund të trajtojë çështjet e të drejtave themelore brenda objektit të nenit 3 (1) të Rregullores (KE) nr. 168/2007 në Shqipëri në masën që është e nevojshme për përafrimin e saj gradual me legjislacionin e BE-së. Për këtë qëllim Agjencia mund të kryejë në Shqipëri detyrat e përcaktuara në nenet 4 dhe 5 të Rregullores (KE) nr. 168/2007.

Vendimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri përcakton, gjithashtu, se Republika e Shqipërisë emëron një vëzhgues dhe një vëzhgues zëvendësues në Bordin e Menaxhimit të Agjencisë (*Management Board*). Personat e caktuar duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 1 të nenit 12 të Rregullores (KE) nr. 168/2007. Ata marrin pjesë në punimet e Bordit të Menaxhimit të Agjencisë mbi baza të barabarta me anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të emëruar nga Shtetet Anëtare të BE-së, por pa të drejtë vote.

Vendimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri përcakton se Shqipëria duhet të kontribuojë financiarisht për realizimin e aktiviteteve të Agjencisë të parashikuara në nenin 4 të Rregullores (KE) Nr.168/2007, sipas Aneksit I që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Bazuar në Marrëveshjen Kuadër të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për zbatimin e IPA II¹ në rast pjesëmarrjeje në programet dhe agjencitë e BE-së, Përfituesi IPA II duhet të paguajë në buxhetin e programit apo agjencisë (neni 20).

Pagesat e detyrueshme për pjesëmarrje do të fillojnë të aplikohen për vitin e parë (2019) nga hera e parë e pjesëmarrjes në këtë Agjenci deri në fund të vitit. Për dy vitet e tjera do të aplikohet në fillim të çdo viti. Kontributi financiar që do të paguhet nga Republika e Shqipërisë në buxhetin e BE-së për të marrë pjesë në Agjencinë e BE-së për të Drejtat Themelore për tri vitet e para do të jetë si vijon:

¹ Ratifikuar me ligjin Nr.37/2015, datë 9.4.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”.

- Viti I: 160 000 euro (21 760 000 lekë);
- Viti II: 163 000 euro (22 168 000 lekë);
- Viti III: 166 000 euro (22 576 000 lekë).

Kontributri i shtetit shqiptar do të jetë 20% e shumës, pasi 80% e vlerës do të rimbursohet nga IPA në dy vitet e ardhshme pas kryerjes së plotë të pagesës. Bazuar në marrëveshjen IPA II “Mbështetje për pjesëmarrjen në programet e BE-së”, ku është parashikuar edhe kontributi i përfituesit dhe kontributi i BE-së për secilin nga programet e BE-së, 80% e shumës do të mbulohet nga IPA, nëpërmjet rimbursimit në dy vitet e ardhshme pas kryerjes së plotë të pagesës dhe pjesa tjetër prej 20% si kontribut i shtetit shqiptar.

Pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në Agjencinë e BE për të Drejtat Themelore do të jetë një ndikim pozitiv në përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me aktet ndërkombëtare.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Ky projektligj nuk ka qëllim përafrimin e legjislacionit europian me legjislacionin shqiptar

Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2019-2021

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjike dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, pika II.3 “Të drejtat themelore”** të Planit Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2019-2021.

Aspektet procedurale të përafrimit

1. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

- **Legjislacioni parësor i BE-së**

Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Titulli V “Marrëveshjet ndërkombëtare”, **nenet 216, 217 (ish-neni 310 TKE) dhe 218 (ish-neni 300 TKE)**; Pjesa e Shtatë “Dispozita të Përgjithshme dhe të Fundit”, **neni 352 (ish-neni 308 TKE)**; Protokolli nr.7 “Mbi privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit”.

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Titulli X “Dispozitat Institucionale, të Përgjithshme dhe Përfundimtare”, **nenet 116 dhe 118.**

- **Legjislacioni dytësor i BE-së**

Rregullorja e Këshillit (KE) Nr.168/2007, datë 15 Shkurt 2007, “Mbi krijimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore”.

Rregullorja (KEE, Euroatom, KEQÇ) Nr.259/68 e Këshillit, datë 29 shkurt 1968 “Mbi përcaktimin e Rregullores së Stafit të Zyrtarëve të lartë dhe kushtet e punësimit të nënpunësve të tjerë të Komuniteteve Evropiane dhe vendosjen e masave speciale të zbatueshme përkohësisht për zyrtarët e Komisionit”, (Rregullorja e Stafit të BE-së).

Neni 216 i TFBE parashikon se Bashkimi mund të lidhë një marrëveshje me një ose më shumë vende të treta apo organizata ndërkombëtare kur këtë e parashikojnë Traktatet ose kur lidhja e një marrëveshjeje është e nevojshme për të arritur, brenda kuadrit të politikave të Bashkimit, një prej objektivave të përmendur në Traktatet, ose parashikohet në një akt me fuqi detyruese ligjore të Bashkimit apo ka të ngjarë të prekë rregullat e përbashkëta ose ta ndryshojë fushën e veprimit të tyre.

Neni 217 i TFBE parashikon se Bashkimi mund të lidhë me një ose më shumë vende të treta ose organizata ndërkombëtare marrëveshje që vendosin një asociim i cili përfshin të drejta dhe detyrime të ndërsjella, veprim të përbashkët dhe procedurë të posaçme. **Neni 217 (ish-neni 310 TKE) përbën edhe bazën ligjore për lidhjen e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë.**

Neni 218 i TFBE parashikon procedurën që ndiqet për të negociuar dhe lidhur marrëveshjet midis Bashkimit dhe vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare.

Neni 352 i TFBE-së është dispozita e fleksibilitetit të kompetencave të BE-së. Pika 1 nenit 352 të TFBE-së parashikon se nëse del nevoja që të veprojë BE-ja, brenda kuadrit të politikave të përcaktuara në Traktatet, për të arritur një prej objektivave të parashikuar në Traktatet, dhe nëse Traktatet nuk i kanë parashikuar kompetencat e nevojshme, Këshilli miraton me unanimitet masat e duhura, me propozim të Komisionit dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Evropian. **Ky nen përbën edhe bazën ligjore për mriatimin e Rregullores (KE) Nr.168/2007 për krijimin e Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore.**

Neni 116 i MSA-së parashikon krijimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri, i cili mbikëqyr zbatimin e MSA-së BE-Shqipëri.

Neni 118 i MSA-së, parashikon se **Këshilli i Stabilizim-Asociimit, me qëllim arritjen e objektivave të MSA-së, ka kompetencën për të marrë vendime brenda objektit të Marrëveshjes,** për çështjet e parashikuara në të. Vendimet e marra janë detyruese për Palët, të cilat do të marrin masat e nevojshme për t'i zbatuar vendimet e marra. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të bëjë rekomandimet përkatëse. Ai harton vendimet dhe rekomandimet e tij me marrëveshje mes Palëve.

Rregullorja e Këshillit (KE) Nr.168/2007 parashikon krijimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (neni 1 i Rregullores). **Objektivi i Agjencisë** është t'u ofrojë institucioneve të BE-së dhe Shteteve të tij Anëtare asistencë dhe ekspertizë lidhur me të drejtat e njeriut kur zbatojnë të drejtën e BE-së (Neni 2). Gjithashtu Rregullorja (KE) nr.168/2007 përcakton fushën e veprimit të Agjencisë (neni 3), detyrat (neni 4), fushat e veprimtarisë së Agjencisë (neni 5), metodat e punës (neni 6) dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse në nivel Evropian dhe ndërkombëtar (nenet 7-9), organizimin (nenet 11-15) dhe funksionimin e Agjencisë (16-19).

Neni 28, pika 1 e Rregullores së Këshillit (KE) Nr.168/2007, parashikon se Agjencia do të jetë e hapur për pjesëmarrjen e vendeve kandidatë si vëzhguese. Pika 2 e këtij neni parashikon se pjesëmarrja dhe modalitetet përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit përkatës të Stabilizim Asociimit, duke marrë parasysh statusin specifik të çdo vendi.

Neni 20 “Pjesëmarrja në programet dhe agjencitë e BE-së” i Marrëveshjes Kuadër të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për zbatimin e IPA II, parashikon se: “Në rast pjesëmarrjeje në programet dhe agjencitë e BE-së, Përfituesi IPA II duhet të paguajë në buxhetin e programit apo agjencisë. Programi kombëtar ose shumëvendësh mund të parashikojë kontribute për koston e pjesëmarrjes së Përfituesit IPA II në programet dhe agjencitë e BE-së”.

- **Konsultimi publik (nëse i është nënshtruar këtij procesi)**

Nuk ka patur konsultim publik në Komision për Integrimin European

- **Efektet financiare të aktit (nëse ka)**

Ky projektligj parashikon ratifikimin nga Kuvendi e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi European- Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr.168/2007”, ku pagesat e detyrueshme për pjesëmarrje do të fillojnë të aplikohen për vitin e parë (2019) nga hera e parë e pjesëmarrjes në këtë Agjenci deri në fund të vitit. Për dy vitet e tjera do të aplikohet në fillim të çdo viti. Kontributi financiar që do të paguhet nga Republika e Shqipërisë në buxhetin e BE-së për të marrë pjesë në Agjencinë e BE-së për të Drejtat Themelore për tri vitet e para do të jetë si vijon:

- Viti I: 160 000 euro (21 760 000 lekë);
 - Viti II: 163 000 euro (22 168 000 lekë);
- Viti III: 166 000 euro (22 576 000 lek.

- **Diskutimi në komision**

Komisioni për Integrimin European vlerësoi pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Agjencinë e Bashkimit European për të Drejtat e njeriut në rolin e vëzhguesit. .

- **Ndryshime të projektaktit (nen për nen)**

Nuk ka

- **Rekomandime**

Nuk ka

- **Përfundim**

- Komisioni për Integrimin European:

- pasi vlerësoi qëllimin e projektligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit si dhe legjislacionit në fuqi;
- pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70 dhe konstatoi se projektligji nuk ka një qëllim të tillë
- pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

KRYETARE

RUDINA HAJDARI